

## Vendim nr. 236 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

- KËRKUES:** EDMOND LESKAJ, përfaqësuar nga avokat Shaqir Hasanaj, me akt përfaqësimi.
- OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-665, datë 09.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 8, 27, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 5, pikat 2 dhe 4, dhe 6 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Edmond Leskaj me disa të bashkëpandehur të tjerë, me vendimin nr. 69, datë 23.11.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është deklaruar fajtor në

mungesë (in absentia), për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, ndaj shtetasit B.D. dhe dënuar me 20 vjet burgim; pjesëmarrjes në bandën e armatosur dhe dënuar me 8 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit S.K. dhe dënuar me 25 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit A.B. dhe dënuar me 25 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit Z.H. dhe dënuar me 25 vjet burgim; vjedhjes me dhunë në dëm të shtetasit A.S. dhe dënuar me 25 vjet burgim; mbajtjes pa leje të armëve luftarake në kuadër të bandës së armatosur dhe dënuar me 10 vjet burgim; në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal (KP), përfundimisht është dënuar me 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi është paraqitur apel nga palët e tjera në procesin penal.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 37, datë 02.07.2010, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokuroria e apelit për krime të rënda dhe të bashkëpandehurit e tjerë.

3. Me vendimin nr. 48, datë 24.02.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës së apelit, për sa u përket dy të bashkëpandehurve të tjerë, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pjesën tjetër.

4. Në datën 30.08.2008 kërkuesi është arrestuar në shtetin italian dhe është ekstraduar në Shqipëri në datën 09.01.2014. Pasi është ekstraduar, ai ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur ankim ndaj vendimit penal nr. 69, datë 23.11.2009 të po asaj gjykate. Me vendimin nr. 12, datë 13.02.2014, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 6, datë 18.03.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 13.02.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3191, datë 22.12.2015, ka vendosur mospranimin e tij.

5. Në datën 21.06.2016 kërkuesi i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar vënien në dispozicion të dosjes së ekstradimit. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. A-536, datë 28.06.2016, ka refuzuar kërkesën, me arsyetimin se kërkuesi duhej t'i drejtohej gjykatës kompetente në lidhje me të. Pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ajo gjykatë me vendimin nr. 891 (80-2017-889), datë 07.03.2017, ka vendosur detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë për t'i vënë në dispozicion informacionin e kërkuar kërkuesit dhe në datën 05.06.2017 dosja e ekstradimit është vënë në dispozicion të tij.

6. Në datën 29.08.2017 kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kërkesë për rishikimin e vendimit penal nr. 69, datë 23.11.2009, bazuar në nenin 51, pika 4, të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet

e Huaja” (ligji nr.10193/2009) dhe nenin 450/dh të KPP-së, për shkak të gjykimit në mungesë dhe garancisë së shprehur nga Ministria e Drejtësisë, se ndaj kërkuesit do të ofrohej mundësia për të rihapur edhe një herë procesin gjyqësor, nëse një kërkesë e tillë do të paraqitej prej tij.

7. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 228, datë 20.09.2017, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkesa nuk plotësonte kushtet ligjore, sipas nenit 450, shkronja “dh”, të KPP-së dhe nenit 51, pika 4, të ligjit nr. 10193/2009, për sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës, i cili është 30 ditë nga mbërritja e të ekstraduarit në Shqipëri. Ekstradimi është kryer në datën 09.01.2014, ndërsa kërkesa për rishikimin e vendimit penal është paraqitur në datën 29.08.2017. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 115, datë 13.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Sipas gjykatës është provuar fakti se kërkuesi ka marrë dijëni për vendimin penal të dënimit të tij në momentin kur është ekstraduar nga autoritetet italiane në datën 09.01.2014. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-665, datë 09.04. 2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit, gjykatat kanë vlerësuar se kërkesa për rishikim nuk plotësonte kushtet ligjore të afatit të paraqitjes së saj në gjykatë, sipas nenit 450 të KPP-së. Po kështu, kërkuesi nuk ka argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural. Sipas Kolegjit, nuk konstatohet se nga gjykata e apelit ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve, ose papërdorshmërinë e provave, apo që vendimi i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 07.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

- 11.1. *Lirinë personale të lidhur me barazinë përpara ligjit*, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë se për dy të bashkëpandehurit e tjerë të cilët ndodheshin në të njëjta pozita me kërkuesin, është ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale, për rrjedhojë edhe masa e dënimit.
- 11.2. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:
- 11.2.1. *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me ankimin efektiv dhe të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi gjykimi në gjykatën e shkallës së parë dhe asaj të apelit për kërkuesin është bërë në mungesë. Në kushtet kur ai është ekstraduar për të vuajtur dënimin në Shqipëri, duhej t'i jepej mundësia të ankohej dhe të dëgjohej, pasi në një proces penal individ nuk duhet të ndëshkohet për shkak të mosnjohimit dhe mosdëgjimit. Po kështu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi ndërkohë që ajo ishte shumë komplekse dhe kërkonte sqarimin e shumë detajeve, nëpërmjet shqyrtimit në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
- 11.2.2. *Standardin e arsyesimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë ligji, duhet t'u jepte përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Në verifikim të plotësisimit të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja

“i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në gjykimin për të cilën janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në Gjykatë.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, konstatohet se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji vë në dukje se neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim Gjykata ka theksuar se, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, afati ligjor 4-mujor llogaritet duke filluar nga data e dhënies nga gjykata të vendimit që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes është i datës 24.02.2014, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 07.08.2024, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-665, datë 09.04. 2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal.

17. Në vlerësimin e Kolegjit, paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Kolegji mban në konsideratë faktin se kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor.

18. Për më tepër, Kolegji vlerëson se në paraqitjen e ankimit kushtetues individual me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të vendimit penal, individët nuk mund të pretendojnë të parashirojnë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor, si mjet i jashtëzakonshëm ankimit, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj.

19. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit *për cenimin e së drejtës për liri personale të lidhur me barazinë përpara ligjit*, i cili ka të bëjë me procesin gjyqësor të themelit është paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor. Ndërsa për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin e rishikimit, Kolegji evidenton se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka

përmbyllur procesin gjyqësor është i datës 09.04.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 07.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

20. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore për rrëzimin e kërkesës për rishikim i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial të lidhur me ankimin efektiv, të drejtën për t’u dëgjuar, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësore, duke parashtruar se gjykimi në gjykatën e shkallës së parë dhe asaj të apelit është bërë në mungesë dhe në kushtet kur ai është ekstraduar për të vuajtur dënimin në Shqipëri, duhej t’i jepej mundësia të ankohej dhe të dëgjohej. Po kështu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi ndërkohë që ajo ishte shumë komplekse dhe kërkonte sqarimin e shumë detajeve, nëpërmjet shqyrtimit në seancë gjyqësore në praninë e palëve.

21. Kolegji vëren se argumenti kryesor i kërkuesit ka të bëjë me faktin se kërkesa për rishikimin e vendimit penal nuk është pranuar nga gjykatat e zakonshme, ndonëse procesi gjyqësor i themelit është bërë në mungesë. Referuar vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vëren se kërkuesi pas ekstradimit në Shqipëri dhe njohjes se ndaj tij ka një vendim penal, ka paraqitur në gjykatë kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, e cila, pasi është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit, nuk është pranuar për shkak të pabazueshmërisë së saj në prova dhe në ligj. Në vijim, ai ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal, për të cilën gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsytimin se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, të përcaktuar në nenin 450, shkronja “dh”, dhe kjo kërkesë është paraqitur në gjykatë pas më shume se 2 vjetësh. Pas ankimimit të këtij vendimi, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të njëjtin arsytimin. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, për të cilin Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk paraqet asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

22. Po kështu për sa i përket shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i saj në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji Penal në dhomë e këshillimi krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kolegji vëren se kërkuesi i ka ushtruar mundësitë ligjore që KPP-ja i njeh, si për sa u përket mjeteve të ankimit, duke paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ashtu edhe për sa i përket kërkesës për rishikimin e vendimit penal, duke u dëgjuar dhe marrë përgjigje të arsyetuar në të gjitha shkallët e gjyqimit, për shkaqet për të cilat gjykatat kanë vendosur rrëzimin e tyre.

24. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me ankimin efektiv dhe të drejtën për t'u dëgjuar, janë haptazi të pabazuara.

25. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për të gjitha pretendimet e kërkuesit, Gjykata ka theksuar se vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomë këshillimi (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kolegji vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuesi, ka vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Nga vendimi i Kolegjit Penal vërehet se ajo gjykatë, në vlerësimin e argumenteve të kërkuesit në tërësi, ka vepruar brenda kompetencave dhe funksionit të saj si gjykatë ligji dhe nuk rezulton të mos ketë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv.

27. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.